



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 1813 prot.

Tiranë, më 29.06.2026

VENDIM

Nr. 64, datë 29.06.2026

**“PËR PRANIMIN DHE PUBLIKIMIN E MJETEVE TË PËRPUTHSHMËRISË  
(AMC) DHE MATERIALET UDHËZUESE (GM) TË EASA, PËR PËRDORIM  
DHE PËR ZBATIMIN E URDHËRIT TË MINSTRIT TË INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË NR. 85, DATË 25.03.2026”**

Në mbështetje të Nenit 14, pika “ë” të Ligjit Nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil” dhe në zbatim të Urdhrit Nr. 85, datë 25.03.2026, të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energji, Për miratimin e rregulloreve për përcaktimin e rregullave për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e Aviacionit Civil” të ndryshuar, në lidhje me Menaxhimin e Rreziqeve të Sigurisë së Informacionit me një ndikim të mundshëm në Sigurinë në Operim,

VENDOSA:

1. Pranimin e Mjeteve të Pranueshme të Pajtueshmërisë (Acceptable Means of Compliance), Materialet Udhëzuese (Guidance Material) të miratuara nga EASA, për zbatimin e rregullores së Komisionit (BE) Nr. 2023/203, e datës 27 tetor 2022, për përcaktimin e rregullave për zbatimin e rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340, Rregulloret Implementuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, dhe për autoritetet kompetente të mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr.748/2012, (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340 dhe (BE) nr. 139/2014, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664 dhe që ndryshon rregulloret e komisionit (BE) nr. 1178/2011, (BE) nr.748/2012, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 139/2014, (BE) nr.

1321/2014, (BE) 2015/340, dhe Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, dhe rregullores (BE) Nr. 2022/1645 që përcakton rregullat për zbatimin e rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm mbi sigurinë në operim për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012 dhe (BE) nr. 139/2014 dhe që ndryshon Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012 dhe (BE) nr. 139/2014 dhe ndryshimet përkatëse të tyre, si më poshtë:

- AMC & GM to the Articles of Regulation (EU) 2022/1645 and Regulation (EU) 2023/203, Issue 1;
  - AMC & GM to the Articles of Regulations (EU) 2022/1645 and 2023/203 — Issue 1, Amendment 1;
  - AMC & GM to Part-IS.AR — Issue 1;
  - AMC & GM to Part-IS.AR — Issue 1, Amendment 1;
  - AMC & GM to Part-IS.D.OR — Issue 1;
  - AMC & GM to Part-IS.D.OR — Issue 1, Amendment 1;
  - AMC & GM to Part-IS.I.OR — Issue 1;
  - AMC & GM to Part-IS.I.OR — Issue 1, Amendment 1
2. Për të siguruar përputhshmërinë me Urdhrin Nr. 85, datë 25.03.2026, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Për miratimin e rregulloreve për përcaktimin e rregullave për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e Aviacionit Civil” të ndryshuar, në lidhje me Menaxhimin e Rreziqeve të Sigurisë së Informacionit me një ndikim të mundshëm në Sigurinë në Operim, do të përdoren AMC, GM të EASA në gjuhën angleze, të pranuar në këtë vendim dhe publikuara në adresën e internetit Acceptable Means of Compliance (AMC) and Guidance Material (GM) | EASA.,
  3. Ngarkohet DAD, DAN, DTL dhe DFS për zbatimin e këtij vendimi dhe për të marrë masa për njoftimin dhe publikimin për organizatat subjekt i këtij vendimi, e pranimit të AMC dhe GM të mësipërme.
  4. Ngarkohen operatorët e aerodromeve, ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror, operatorët ajrorë, organizatat e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të mirëmbajtjes dhe organizatat e trajnimit për ndjekjen dhe zbatimin e AMC, GM të mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Maksim Ethemaj**

